



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOS  
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 37364  
U. Br.

Nr. i faq. 4 Data 24/12  
Br. str. Datum: 2024

KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality



Mbështetur në nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr.04/2017, mbi Financimin Publik të OJQ-ve , si dhe Rregullores për Kushtet, Kriteret, dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve , me nr. 31251 – 09/2022,  
Zyra e Kryetarit shpallë:

### **THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS SHKENCORE “KAMENICA NË RRJEDHA TË HISTORISË”**

Komuna e Kamenicës fton organizatat joqeveritare (OJQ) të regjistruara dhe me fokus në aktivitetet kulturore që të aplikojnë për mbështetje financiare për organizimin e Konferencës Shkencore "Kamenica në Rrjedha të Historisë".

Kjo konferencë, do të mbahet më 20-21 shkurt 2025, dhe synon të mbledhë studiues nga fusha të ndryshme për të prezantuar punime shkencore origjinale mbi historinë e Kamenicës, duke përfshirë periudhat nga antikiteti deri në atë bashkëkohore.

**Afati për aplikim:** Thirrja për aplikim është e hapur deri më **10 janar 2025**.

**OJQ-të kulturore mund të aplikojnë për mbështetje financiare për organizimin e aktiviteteve të mëposhtme:**

- Organizimi i sesioneve shkencore dhe prezantimeve akademike,
- Ekspozita me tematikë historike dhe kulturore për Kamenicën,
- Botimi i materialeve akademike (abstrakte, kumtesa, akte të konferencës),
- Promovimi dhe mbulimi mediatik i konferencës,
- Organizimi i eventeve shoqëruese, si ekskursionet në vendet historike dhe monumentet e Kamenicës,

- Dokumentimi vizual i konferencës,
- Aktivitete të tjera relevante me natyrën e konferencës.

**Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare, OJQ-të duhet të plotësojnë këto kritere:**

- Të jenë të regjistruara si organizata jo-qeveritare dhe të kenë certifikatën e regjistrimit si dhe numrin fiskal.
- Të dorëzojnë një projekt-propozim dhe një buxhet të detajuar sipas formatit të kërkuar.
- Të dorëzojnë CV-në e menaxherit të projektit dhe përshkrimin e kapaciteteve të organizatës.
- Aktivitetet e propozuara të jenë të orientuara drejt qëllimit të konferencës dhe të realizohen në territorin e Komunës së Kamenicës.
- Të dorëzojnë deklaratat e partneritetit në rast se projekti përfshin bashkëpunime.

**Kriteret e vlerësimit:**

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- Të posedojë OJQ-ja, respektivisht, kapacitete profesionale për të kryer aktivitetet e planifikuara të projektit/programit (a kanë aftësitë e duhura dhe aftësitë për zbatimin e projektit, si dhe njohuri në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë ftesë)?
- Të posedojë kapacitete të menaxhimit të mjaftueshme OJQ-ja (duke përfshirë personelin, pajisjet për të udhëhequr me projektin)?
- Sa relevant është projekt-propozimi për qëllimet dhe fushat të ftesës publike (a ndërlidhet projekti me aktivitetet e parapara me politikat e fushës, të cilat i mbulon ftesa publike)?
- A janë objektivat e projektit/programit të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme?
- A janë aktivitetet e projektit / programit të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme?
- A janë kostot e projektit/programit reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit?

**Vlera e financimit:**

Shuma totale e planifikuar për këtë thirrje: 15,000 euro.

Shuma minimale për një projekt: 5,000 euro.

Shuma maksimale për një projekt: 15,000 euro.

**Periudha e realizimit të projekteve:**

Të gjitha aktivitetet duhet të përfundojnë deri më 21.03.2025.

**Dorëzimi i aplikacioneve:**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht në adresën e mëposhtme:

**KOMUNA E KAMENICËS**

**Rr. "Skënderbeu"**

**Objekti i Administratës Komunale**

**Qendra për Shërbim me Qytetarë**

**Procesi i pranimit hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve përfshinë,**


- **Vlerësimi i aplikacioneve;**
- **Kontraktimi;**
- **Dhënia e fondeve;**
- **Koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave.**

Formularët për aplikim dhe udhëzimet e detajuara mund të shkarkohen nga faqja zyrtare e Komunës së Kamenicës: <https://kk.rks-gov.net/kamenice>

Vetëm aplikacionet e dorëzuara brenda afatit dhe që përmbushin kriteret e përcaktuara do të merren në konsideratë për mbështetje financiare.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen te zyrtari përgjegjës, **Lidiona Marovca** , në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: [Lidiona.marovca@rks-gov.net](mailto:Lidiona.marovca@rks-gov.net) ose në numrin kontaktues +383 (0) 45 903 396 gjatë orarit të punës 08:00-16:00h (e hënë – e premte).

**Kryetari**



**Kadri Rahimaj**

1. The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions, including sales, purchases, and expenses. It emphasizes the need for regular reconciliation and the use of reliable accounting software to ensure data integrity.

2. The second part covers the various methods used to calculate and report profit margins, highlighting the difference between gross and net profit. It also touches upon the impact of depreciation and amortization on the company's financial statements.

3. The third part of the document addresses the role of budgeting and forecasting in financial management. It explains how these tools help in identifying potential risks and opportunities, and in making informed decisions about resource allocation.

4. Finally, the document concludes by discussing the importance of transparency and communication in financial reporting. It stresses the need for clear and concise reports that provide stakeholders with a comprehensive view of the company's financial health.